




AUTOR
**Megi
Ndregjoni**

SHKELJA E TË DREJTAVE TË NJERIUT GJATË PROTESTËS KUNDËR RRITJES SË ÇMIMEVE



RAPORT MONITORIMI

MARS-PRILL 2022

QENDRESA
QYTETARE



NED

NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al

KONTEKSTI

E drejta e tubimit paqësor është themelore në një shoqëri demokratike. Kështu është shprehur Gjykata e të Drejtave të Njeriut në një prej vendimeve të saj¹. Liria e tubimeve paqësore dhe pa armë, si dhe e pjesëmarrjes në to, garantohet në nenin 47, pika 1, të Kushtetutës. Kjo liri nuk kufizohet nga qëllimi i tubimit, mjafton që ai të jetë paqësor.

Liria e tubimit paqësor merr rëndësi të veçantë në një shtet ligjor dhe demokratik. Neni 11 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, e cila është ratifikuar nga vendi ynë garanton lirinë e tubimit dhe të organizimit. Sipas këtij neni, çdokush ka të drejtën e lirisë së tubimit paqësor dhe të organizimit me të tjerët. Ushtrimi i kësaj të drejte nuk mund t'i nënshtrohet kufizimeve të tjera përveç atyre që parashikohen me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për ruajtjen e shëndetit ose të moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve.

Në datat 9-10 Mars 2022, shumë qytetarë protestuan kundër rritjes së çmimeve të hidrokarbureve dhe çmimeve të produkteve të tjera të konsumit (si ato të shportës), të papërballueshme për kushtet sociale-ekonomike të shtetasve në vendin tonë. Ata kërkuan uljen e çmimeve të karburanteve në nivelet e vendeve të rajonit. Më pas bllokuan kryqëzimet dhe bënë thirrje për përfshirje të vazhdueshme në protesta. Të enjten dhe të premten protestat në Tiranë u bënë më të mëdha duke numëruar mijëra, dhe protesta të tjera madhore janë përhapur në Durrës, Krujë, Berat, Lushnjë, Korçë, Prrenjas, Shkodër, Dibër, Elbasan etj.

Qytetarët më pas zhvilluan një tubim kombëtar ku mijëra qytetarë kaluan bulevardin kryesor nga qendra e qytetit duke drejtuar përpara godinës së Kryeministrisë. Me pankarta "Boll na vodhet", ata paraqiten edhe një herë kërkesat kryesore ndaj qeverisë për uljen e çmimit të karburanteve dhe ushqimeve bazë, duke i rikthyer dinjitetin qytetarit përmes një qeverie transparente dhe të përgjegjshme.

Që nga protesta e parë e deri më tani dhjetëra qytetarë janë ndaluar në komisaritet e Tiranës. Sipas burimeve policore më shumë se 40 janë shoqëruar në komisariat, ndërsa sipas protestuesve dhjetëra janë të arrestuar.

Qëllimi i këtij raporti është nxjerrja në pah e shkeljeve të lirisë së tubimit dhe lirisë së shprehjes e mendimit. Ky raport është bazuar dhe në raportet e Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KShH) dhe të Avokatit të Popullit.

Ajo që do të trajtohet në këtë raport është:

1. Liria e Tubimit, duke marrë parasysh kriteret që ka përcaktuar GJEDNJ, për kufizimin e kësaj të drejte.
2. Lirinë e medias, në kuadër të lirisë së tubimit, duke marrë parasysh ndalimin e gazetarëve përgjatë protestës.

¹ Shih Kudrevičius dhe të tjerë kundër Lituanisë, 15 tetor 2015, § 91

2. Cenimi i lirisë së tubimit

Rreth 50 qytetarë² u arrestuan me justifikimin se nuk kanë marrë leje dhe se kanë bllokuar trafikun në qytetin e Tiranës. Raporti i monitorimit të KSHH thekson se si shkak i shoqërimit në procedurat e dokumentuara pranë Policisë ishte vendosur "Protesta dhe/ose Bllokim rruge".

Në lidhje me justifikimin e protestës së paligjshme, për shkak të mungesës së lejës, Gjykata Kushtetuese përgjatë vitit të kaluar shfuqizoi nga Kodi Penal, togfjalëshin "pa marrë leje të organit kompetent". Gjykata u shpreh se në Kodin Penal³ përdoret fjala leje ndërsa në ligjin për tubimet përdoret fjala njoftim. Kjo krijon pasiguri juridike të qytetarët, pasi fjalët kanë kuptim të ndryshëm.

Ky vendim i Gjykatës ka theksuar një element të rëndësishëm në lidhje me lirinë e tubimit: Organizatorët nuk duhet të marrin leje për të organizuar një protestë pasi kjo çënon në thelb lirinë e tyre, por ata duhet të njoftojnë me shkrim organet kompetente. Në këtë mënyrë realizohet dhe e drejta e një grupi qytetarësh dhe ruajtja e rendit publik në vend. Kujtojmë se neni 262 është përdorur gjërësisht në të kaluarën për të arrestuar organizatorë apo pjesëmarrës në një tubim apo protestë. Tashmë Kuvendi do duhet të miratojë një dispozitë të re në Kodin Penal, duke u bazuar në atë që ka referuar Gjykata Kushtetuese. Kjo do të thotë se duhet që qeveria, deputetët apo 20 mijë zgjedhës të nisin procedurën ligjvënëse për të plotësuar këtë dispozitë. Norma e re duhet të jetë në përputhje dhe me ligjin për tubimet. Vendimi i Gjykatës duhet të shërbejë për deputetët në mënyrë që norma e re të respektojë të drejtën e tubimeve. Ajo argumentoi se ky nen cenon lirinë e tubimit.⁴

Në lidhje me justifikimin e bllokimit të qarkullimit të makinave në qytet, Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut ka përcaktuar disa kritere, të cilat duhet të merren parasysh për të konsideruar shqetësuese protestën. GJEDNJ në parim i kërkon autoriteve të balancojë të drejtën e atyre që duan të protestojnë dhe atyre që u shkelet e drejta e lëvizjes. Për të vendosur nëse protesta duhet shpërndarë, autoritete duhet të konsiderojnë:

- a) kohëzgjatjen e ndërprerjes së trafikut,
- b) dijeninë që autoritetet kanë për protestën
- c) nëse bllokimi i trafikut është serioz.

Le ti marrim me rradhë këto kritere. Lidhur me kohëzgjatjen, GJEDNJ ka kritikuar në disa raste autoritetet e shteteve pasi kanë vepruar shpejt për të ndaluar protestat që bllokojnë trafikun.⁵ Mbi dijeninë e protestës, Gjykata e ka bërë të qartë se ajo çka vlen është nëse autoritet kanë dijeni mbi protestën, dhe jo nëse janë njoftuar paraprakisht. Serioziteti i bllokimit të trafikut lidhet me ndikimin që ka protesta në qarkullimin e mjeteve.

² <https://www.reporter.al/2022/03/12/gjykata-gjen-paligjshmeri-ne-arrestimet-e-protestuesve-ne-tirane/>

³ Për më shumë shih nenin 262 të Kodit Penal

⁴ Për më shumë lexo Vendim nr. 24 datë 04.05.2021

⁵ Çështja Ataman kundër Turqisë/ Balçik e të tjerët kundër Turqisë.

Protesta e qytetarëve ishte bërë tashmë publike pasi në të gjitha rrjetet sociale ishin publikuar njoftimet për organizimin e protestës. Ndërkohë që protestuesit bllokuan vetëm disa minuta kryqëzimin te bulevardi "Dëshmorët e Kombit". Kjo patjetër që nuk e bën aspak serioz bllokimin e trafikut, duke marrë të mirëqenë se trafiku në Tiranë është një normalitet.

Një problematikë tjetër e vënë re gjatë ndalimeve e arrestimeve të protestuesve, ishte mungesa e shkakut ligjor të shoqërimit të protestuesve, konform kërkesave të nenit 109 të ligjit nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit". KSHH shkruan në raportin e tij se:

"Gjatë verifikimit në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, si dhe në Komisariatet e Policisë nr. 3 dhe nr. 5, vëzhguesit e KShH-së konstatuan se nuk ishte shënuar në dokumentacion shkak ligjor i shoqërimit të protestuesve, konform kërkesave të nenit 109 të ligjit nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit". Si shkak i shoqërimit në procedurat e dokumentuara në këto institucione ishte vendosur "Protesta dhe/ose Bllokim rruge", fakt që bie në kundërshtim me procedurat standarde të miratuara nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit. Gjithashtu, shoqërimi/arrestimi në flagrancë për shkak të protestës, sikurse është reflektuar në disa raste në regjistrat e kqyrur nga vëzhguesit, bie ndesh dhe është në shkelje me garancitë e të së drejtës së tubimit, të parashikuar në nenin 47 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 11 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut"⁶

Ashtu sikurse është parë në media, shumë efektivë policie kanë qënë pa numër identifikimi, gjë e cila shkel sigurinë juridike. Sipas "Ligjit për Policinë e Shtetit" secili prej efektivëve është i pajisur me një numër identifikimi për të garantuar sigurinë e qytetarëve.

⁶ Për më shumë shih Raport i Veçantë Monitorimi "Verifikimi i respektimit të standardeve mbi procedurat e shoqërimit, ndalimit apo arrestimit në flagrancë të disa shtetasve, pjesëmarrës në protestat e realizuara për rritjen e çmimeve, në datat 9-10 Mars 2022"

3. Cënimi i lirisë së medias gjatë protestës për rritjen e çmimeve

E drejta e lirisë së shprehjes përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë shtetërorë. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike.

Për gazetarët dhe mediat liria e shprehjes është e rëndësishme për shkak të rolit të tyre në zbulimin e së vërtetës, informimin e publikut, mbajtjen përgjegjës të politikanëve, kërkimit të llogaridhënies nga autoritetet publike dhe të drejtën që të jenë vazhdimisht skeptikë ndaj veprimeve të qeverisë. Në veçanti, duke e informuar publikun, gazetarët i mundësojnë publikut që të marrë pjesë në vendimmarrje dhe në zhvillimin e demokracisë. Për këtë arsye, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) i sheh gazetarët si mbikëqyrës publikë, roli i të cilëve është të shpërndajnë informacione dhe ide përmes mjeteve të ndryshme si televizioni, gazetat, mediat online dhe mjeteve tjera të informimit.

Gjatë protestës kundër rritjes së çmimeve, është raportuar dhunë dhe presion ndaj gazetarëve. Rastet e konfirmuara janë ndaj operatorit të Syri TV dhe JOQ.

Duhet theksuar se pengimi i gazetarëve për të mbledhur informacion dhe raportuar gjatë protestave është shkelje e nenit 10 të KEDNJ për lirinë e shprehjes. GJEDNJ ka argumentuar më herët se dhuna ndaj gazetarëve në protestë përbën shkelje të lirisë së shprehjes. Në çështjen Butkevitch v. Russia, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka sqaruar se mbledhja e informacionit është një element thelbësor në gazetari dhe një pjesë e qenësishme e mbrojtjes së lirisë së shtypit.

Gjykata vendosi se arrestimi i gazetarit Butkevich ndërkohë që ai po bënte fotografi dhe po mblidhte informacion gjatë protestës, kishte shkelur të drejtën e tij për lirinë e shprehjes, e drejtë kjo e mbrojtur nga neni 10 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Madje, në rastin konkret, edhe pse gazetari Butkevitch nuk kishte qënë i alokuar në terren nga media ku ai punonte, Gjykata njohu të drejtën e tij për të mbledhur informacion dhe material fotografik lidhur me një event publik.

Rasti i arrestimit të gazetarëve në fjalë është jo vetëm shkelje e ligjit të brendshëm, por dhe Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe praktikës së GJEDNJ.

GJETJET KRYESORE



- Gjatë protestës për rritjen e çmimeve policia ka arrestuar në mënyrë të padrejtë për 50 qytetarë.



- Policia ka patur dokumentacion të mangët për shkaqet ligjore të ndalimit apo arrestimit, gjë e cila u identifikua dhe nga Gjykata e Tiranës



- Policia ka shkelur me arrestimet e ndalimet lirinë e tubimit dhe lirinë e media, duke ndaluar operatorë të Syri TV dhe JOQ, në raportimet e tyre të protestës.



- Efektivët e Policisë nuk kishin numrat e identifikimit në kundërshtim me Ligjin e Policisë.

REKOMANDIME



- Është e nevojshme që Policia e Shtetit të trajnohet mbi standartet e GJEDNJ në lidhje me arrestimet e ndalimet dhe kur duhet të përdorë dhunë.



- Qytetarët nuk duhet të marrin leje, por duhet të njoftojnë Drejtorinë e Policisë për vendin dhe kohën e protestës.



- Kuvendi prej më shumë se 10 muajsh nuk ka miratuar ndryshimet më Kodim Penal sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese.